



UNIVERSITETI POLITEKNIK
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË INFORMATIKE

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË
KANDIDATËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT BACHELOR
NË INXHINIERI INFORMATIKE**

Tiranë, 2012



UNIVERSITETI POLITEKNIK
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË INFORMATIKE

I. Të përgjithshme

Neni 1

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit i cili është krijuar në dhjetor 2007 bazuar në VKM Nr. 824, datë 05.12.2007 për “Krijimin e disa njësive kryesore, fakultete, në Universitetin Politeknik të Tiranës”.

Neni 2

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, për t’i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, lidhur me fushat e Inxhinierisë Informatike dhe të fushave të ngjashme.

Neni 3

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike është një program studimi i nivelit të parë i hapur pranë Departamentit të Inxhinierisë Informatike në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, UPT.

Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

II. Organizimi

Neni 5



UNIVERSITETI POLITEKNIK
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË INFORMATIKE

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT dhe drejtohet nga Departamenti i Inxhinierisë Informatike si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 6

Detyrat e Departamentit të Inxhinierisë Informatike janë:

- Paraqitja e programit të studimit për miratim në këshillin e fakultetit dhe senatin e UPT
- Përgatitja e planit mësimor
- Rishikimi i programeve mësimore
- Hartimi i strukturës mësimore
- Menaxhimi i të gjithë aktiviteteve mbështetëse për mbarëvajtjen e programit të studimit

Neni 7

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike organizohet pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në korpusin universitar Sheshi “Nënë Tereza”, si dhe pranë laboratorëve të Departamentit të Inxhinierisë Informatike.

Neni 8

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike kryen të gjitha regjistrimet e veta nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

III. Pranimi i kandidatëve

Neni 9

Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike mund të regjistrohen persona sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP). Kandidatët fitues përcaktohen nga AKP në bazë të parimeve të Meritës dhe Preferencës, lista e fituesve shpallet në faqen Informatike të MASH dhe AKP.

Neni 10



UNIVERSITETI POLITEKNIK
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË INFORMATIKE

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FTI dhe UPT. Kandidatet regjistrohen sipas procedurave të miratuara nga FTI.

Neni 11

Regjistrimet në Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike bëhen në zbatim dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe vendimet e udhëzimet e MASH. Ato kryhen pranë sekerarisë mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 12

Njohja e krediteve bazohet në rregulloren e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 13

Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UPT, rregulloren mësimore të UPT dhe rregulloren e brendshme të FTI.

IV. Zhvillimi i aktiviteteve

Neni 14

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike zhvillohet me kohë të plotë. Ai zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe lëndët zhvillohen sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet gjithashtu dhe praktika profesionale dhe mbrojtja e diplomës. Diploma është një punim i pavarur i studentit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike.

Neni 15

Gjuha në të cilën zhvillohet program i studimit Bachelor në Inxhinieri Informatike është gjuha shqipe.



UNIVERSITETI POLITEKNIK
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DEPARTAMENTI I INXHINIERISË INFORMATIKE

Neni 16

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FTI.

Neni 17

Kontrolli i dijeve në çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesëmarrjes në laborator dhe provës përfundimtare, provimit.

Neni 18

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UPT-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FTI-së.

Neni 19

Rezultatet e frekuentimit, provave përfundimare të moduleve dhe të mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 20

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë “Bachelor në Inxhinieri Informatike” të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe nga Rektori i UPT-së.

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. As. Elinda Kajo Meçe